

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PUNËSIM
NË S.U.O.GJ. "KOÇO GLIOZHENI" NË POZICIONIN E PUNËS
Receptionist-e/punonjës-e informacioni

Bazuar në kreun III, pika 4 të Statutit “Për procedurat e marrjes në punë në S.U.O.GJ. "Koço Gliozheni" dhe në Vendimin e Bordit të spitalit Nr. 4 dt. 16.12 2022 “Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", shpallet thirrja për aplikim për pozicionin e lirë të punës: *Receptionist-e/punonjës-e informacioni, në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" Tiranë.*

Dorëzimi i dokumentave bëhet deri 24 Maj 2024

pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni",
në adresën Blv. “Bajram Curri” 9 (sipër Brryllit), Tiranë (brenda orarit zyrtar)

Pozicioni: **Receptionist-e/punonjës-e informacioni në S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" Tiranë - 1 (një) punonjës**

Përshkrimi i detyrave dhe karakteristikave të punës:

1. Ka varësi direkte dhe është pjesë e Sektorit të Hotelerisë;
2. Drejton, jep informacionin dhe bën veprimet e duhura për të gjithë ato pacientë apo familjarët e tyre që paraqiten në Spital për shtrim apo vizitë specialisti, konsulta, ekzaminime, etj për në pavionet apo shërbimet mjekësore përkatëse;
3. Përgjigjet për mbajtjen, plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës (regjistra, kupona, etj). Bën regjistrimin e pacienteve ambulatorë që kërkojnë shërbim mjekësor ambulator në spital, duke zbatuar udhëzimet në fuqi.
4. Duhet të njohë dhe të zbatojë udhëzimet në fuqi, për shërbimet ambulatore në Spital, siç janë:
 - a) Urdhërat dhe Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi funksionimin e sistemit të referimit të pacientit në shërbimin shëndetësor”.
 - b) Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë “Mbi tarifatat për vizitat ambulatore tek specialisti për konsultat apo ekzaminimet laboratorike, imaxherike, ndërhyrjet kirurgjikale ambulatore, etj.”
 - c) Udhëzimin për përjashtimin e personave nga pagesa sipas kategorive të personave që konsiderohen të siguruar.
5. Duhet të ketë të afishuar tarifatat përkatëse dhe listën e kategorive të personave, që konsiderohen të siguruar. Për çdo rast (vizitë, konsultë, ekzaminime ambulatore) që kërkon pagesë sipas tarifave të caktuara, pret kuponin në tre kopje: një për kabinetin mjekësor, një për degën e financës dhe një kopje e mban për vetë. Të ardhurat e grumbulluara dorëzohen brënda ditës tek ekonomistja sipas udhëzimeve të degës së financës, dhe ekonomistja i dorëzon në arkën e llogarisë së drejtorisë.
6. Përgjigjet për rregullimin dhe higjenën e vëndit të punës, zbaton orarin e punës të përcaktuar nga Drejtoria.
7. Përgjigjet për informimin dhe sjelljen me edukatë dhe kulturë me pacientin, familjarët dhe vizitorët që paraqiten në Spital.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret si vijon:

Kritere të përgjithshme:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrat;
- c) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale;
- d) Të mos ketë masa disiplinore, që nuk u janë shuar efektet;

Kritere të posaçme:

- a) Të ketë kryer arsimin e mesëm (arsimi i lartë në degë që lidhen me profilet e punës me komunikimin me publikun do të përbëjë përparësi);
- b) Të ketë minimumi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune, (nga të cilat të paktën 1 (një) vit në pozicione pune, që i përngjajnë profilit të punës të pozicionit);
- c) Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara në rregulloren e brendshme të institucionit si dhe kërkesat e titullarit të institucionit;
- d) Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë;
- e) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe fleksibilitet në zgjidhjen e problematikave të krijuara në funksion të mbarëvajtjes së punës.
- f) Të ketë aftësi të mira për të punuar në grup dhe për të trajtuar në mënyrë efikase situata të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet me pacientët dhe familjarët. Njohja e një gjuhe të huaj (të vendeve të BE) përbën përparësi.

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së arkivë-protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", Tiranë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë me shkrim/Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim (CV) të përditësuar, (ku të përfshihen të dhënat e kontaktit – numër telefoni/e-mail);
- c) Diplomat e shkollës, listat e notave /fotokopje të njehsuara me origjinalin. (Diplomat dhe dokumentacioni që vërteton arsimimin, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet e saj, që vërtetojnë eksperiencën në punë)/vërtetim të periudhave të punësimit nga sigurimet shoqërore;
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID-së) ;
- f) Raport mjekësor për aftësinë në punë/vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim ;
- i) Vërtetim banimi;
- j) Vlerësimin e fundit nga eprori i drejtëpërdrejtë (nëse ka);
- k) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka);
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

Dokumentet mund të jenë origjinale apo të njehsuara me origjinalin.

Dokumentet e përfutuara në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara sipas ligjit.

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen/dërgohen në Zyrën e Arkivë-Protokollit të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni", në adresën Blv. "Bajram Curri" (sipër Brrylit), Tiranë deri në datën 24.5.2024 (brenda orarit zyrtar), sipas një formati, i cili përshkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialisti, që merr në dorëzim kërkesën dhe aplikanti përkatës.

Aplikantët që plotësojnë kriteret, nëpërmjet aplikimit dhe dokumentacionit përkatës, njoftohen individualisht për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të intervistës me gojë nga Sektori i Burimeve Njerëzore të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" në kontaktet e përcaktuara nga aplikantët në CV-të përkatëse.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve :

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacion e dorëzuar, lidhur me kriteret, përvojën dhe kualifikimet e lidhura me fushën e pozicionit të punës, si dhe gjatë intervistës me gojë lidhur me njohuritë mbi fushën, aftësitë, eksperiencën e mëparshme, kompetencën, motivimin dhe pritshmëritë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

Totali i pikëve është 40 dhe do të kryhet sipas tabelës së Shtojcës 1 të Vendimit të Bordit të spitalit Nr. 4 dt.16.12 2022 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Strukturën Organizative të S.U.O.Gj. "Koço Gliozheni" (*bashkëlidhur njoftimit*).

Dalja e rezultateve të konkurimit dhe komunikimi i tyre

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të njoftohet nëpërmjet kontakteve të shënuara në aplikimin e paraqitur nga ana e këtij të fundit.

SHTOJCA 1

Kriteret e vlerësimit të dosjes për kandidatët:

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvojë pune në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite experiencë pune)	0-10 pikë
2	Nota mesatare e studimeve të larta, Vleresimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë	0 -10 pikë
3.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/-ve të huaja, maksimumi 4 pikë: Gjuhë e huaj e mbrojtur = 2 pikë	0-4 pikë
4.	Studime shtesë deri-4 pikë; Master profesional 1 pikë, Master shkencor - 2 pikë; Diplomë shtesë- 4 pikë	0- 4 pikë
5.	Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifiki që lidhen me fushën- maksimumi 2 pikë: trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në tre muaj - 1 pikë; kualifikime nga 3 muaj e më shumë- 2 pikë;	0-2 pikë
6.	Intervista dhe referencat e punësimeve të mëparshme	0-10 pikë